



Datë: 07.04.2025
Numër Protokolli: 3757/2025

A.nr.339/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.339/2025, të datës 20.02.2025, të parashtruar nga ankuesi A.H, kundër organit të punësimit-Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kundërshtim i shqiptimit të masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 07.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.339/2025, e datës 20.02.2025, e parashtruar nga ankuesi A.H.

II. Anullohet Vendimi me Nr. ref.01/2025, i datës 24.01.2025, i Komisionit Disiplinor, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

III.Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e bërë kompensimin e pagës së ankuesit për periudhën e ndaluar sipas vendimit të anuluar si në pikën II dhe së masën e anuluar sipas pikës II, ta largojnë nga regjistri personal i ankuesit.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.H (*referuar tutje ankuesi*), më datë 20.02.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. ref.01/2025, të datës 24.01.2025, të Komisionit Disiplinor, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1131/2025, të datës 20.02.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. ref.01/2025, të datës 24.01.2025, të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 12.11.2024; Vendimin me Nr.Ref.336/2024 të datës 09.08.2024 të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emailin e datës 24.09.2024 nga Zyra e Sekretarit në MPJD për ankuesin; Emailin e datës 25.09.2024 nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD; Emailin e datës 13.11.2024 nga Burimeve Njerëzore MPJD për ankuesin; Emailin e datës 01.01.2025 nga E.D për ankuesin; Emailin e datës 09.01.202, 25.12.2024 nga ankuesi për E.D, Z.G dhe A.M; Emailin e datës 26.12.2024 nga E.B për ankuesin; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 10.01.2025; Akt Emërimit me Nr. 873.2024 të datës 01.08.2024; Vendimin me Nr. ref.285/2022 të datës 01.09.2022; Vendimin me Nr. ref.515/2022 të datës 18.08.2022; Vendimin me Nr. 46/09 të datës 23.11.2009; Akt Emërimit e datës 07.10.2013; Shkresën e datës 09.01.2025 nga ankuesi për Komisionin Disiplinor të MPJD, Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD; Ftesë për shkrehje të interesit e datës 30.03.2023 nga Rotacioni MPJD; Vendimin me Nr.ref.281/2023 të datës 14.04.2023; Vendimin me Nr.ref.623/2022 të datës 24.11.2022; Deklaratën e Bashkësisë Familjare F11746938 të datës 01.10.2024; Dëshmi nga Hopitaux Universitaires Geneve lidhur me gjendjen shëndetësore të vajzës së ankuesit të lëshuara në vitin 2021 dhe 2022; Kopjen e ID-së së ankuesit; Përgjigjen në ankesë e datës 10.03.2025; Vendimin me Nr. ref.635/2018 i datës 23.01.2018; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 24.12.2024; Vendimin me Nr. re.458/2023 të datës 01.12.2023 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 01.04.2025 për shtytjen e afatit të vendosjes së ankeses së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është tërësisht e bazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i provave të rrjedhë së ankuesi është i punësuar në MPJD dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit Nr. 873/2024 të datës 01.08.2024, ushtron pozitën Zyrtar i Lartë për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare.

Tutje, sipas provave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi ka shërbyer në shërbimin e jashtëm për disa vite, ashtu që, i njëjti fillimisht sipas Vendimit me Nr. 46/09, të datës 23.11.2009, të Ministrit të MPJ-së ka ushtruar pozitën Këshilltar në Ambasadën e Kosovës Romë/Republikën e Italisë, e më pastaj sipas Vendimit me Nr.Ref. 635/2018, të datës 23.01.2018, të Ministrit të MPJ, është caktuar të shërbej në Konsullatën e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës në Gjenevë/Konfederatën e Zvicrës, për një mandat katër vjeçar nga data 01.09.2018, më gradë diplomatike Ministër Këshilltar.

Me tej, më Vendimin me Nr. Ref. 336/2024 të datës 09.08.2024 të Ministrit të MPJD-së, ankuesi në gradën Ministër Këshilltar është caktuar të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dakar/Senegal, me mandat katër vjeçar, duke filluar nga data 01.10.2024, mirëpo, ankuesi përmes emailit të datës 25.09.2024, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, ka njoftuar te njëjtin se ka të pamundur shkuarjen në këtë shërbim të jashtëm sipas këtij vendimi, për shkak të gjendjes delikate shëndetësore të vajzës së tij (afër 3 vjeçare) dhe rrethanave tjera familjare, duke i kërkuar mirëkuptimin për shëndetin dhe mirëqenien e fëmiut në këtë rast.

Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, përmes parashtresës më numër të protokollit 6037, të datës 12.11.2024, ka bërë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me supozimet se: *në mbështetje të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullore (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil. Ekziston dyshimi i bazuar se z. A.H ka kryer shkelje të rëndë të detyrës së punës: moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, dhe detyrimeve ligjore të përcaktuar në legjislacionin e shërbimit të jashtëm si dhe ushtrimi me ndershmëri dhe korrektësi i funksionit dhe detyrave të ngarkuara në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës, përkatësisht: Mos zbatim i Vendimit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për caktimin që të shërbej ne Dakar/Senegal dhe Mos gatishmëri për të shërbyer kudo në botë dhe mos përmbushje e zotimit për të shërbyer nevojave dhe prioriteteve të MPJD-së.*

Komisioni Disiplinor i MPJD-së, më Vendimin me Nr. ref.01/2025, të datës 24.01.2025, ka shpall përgjegjës ankuesit për shkelje disiplinore, duke i shqiptuar masën disiplinore *ndalimi i njëzet për qind (20%) e pagës bazë për periudhën për katër (4) muaj.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin Nr. ref.01/2025, të datës 24.01.2025, të Komisionit Disiplinor, të MPJD-së më pretendimet së vendimi për caktim në mision diplomatik në Dakar/Senegal është marr pa ndonjë njoftim paraprak dhe në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin e jashtëm; Iniciimi i procedurës disiplinore është bërë pa ndonjë bazë ligjore dhe pa argumentim të fakteve nëse kemi të bëjmë me shkelje disiplinore; Aplikim i gabueshëm i dispozitave ligjore dhe mungesa e bazës ligjore për iniciimin e procedurës disiplinore ngase pretendimet mbi bazë të cilave është iniciuar procedura disiplinore e ku iniciuesi i referohet Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk është në fuqi, ndërsa me nenin 56 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është parashikuar iniciimi për një çështje të tillë siç pretendon iniciuesi. Komisioni Disiplinor ka nxjerr vendim në kundërshtim me afatet ligjore të përcaktuar me nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil ngase iniciimi i procedurës disiplinore edhe bërë më datë 12.11.2024 ndërsa vendimi është nxjerr më datë 24.01.2025.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë, Kolegji*

konstaton së ankesa është e pranueshme, ngase ankuesi ka legjitimitetin e palës dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion në pikëpamje materiale për trajtimin kësaj çështje siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se *1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë...*” Kolegji i Këshillit konstaton së nëpunësit e shërbimit të jashtëm kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht marrëdhënia e punës dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Në kontekst të përcaktimit si më lartë, Kolegji thekson faktin së Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka në fuqi ndonjë akt ligjor apo nënligjor që rregullon specifikisht çështjet lidhur me caktimin/sistemimin e nëpunësve civilë në shërbim diplomatik-konsullor, transferimin dhe ndërprerjen e shërbimit diplomatik-konsullor si dhe disiplinën, edhe pse në praktiken tani më të konsoliduar të vendimmarrjes në Këshill janë dhënë udhëzime që MPJD për shkak të specifikave të fushës së veprimit duhet të ketë procedura të qarta lidhur më çështjet si me sipër. Andaj, në mungesë të një rregullimi të veçantë, trajtimi i çështjes ankimore do të behët në pajtim më dispozitat e Ligjit bazik për zyrtarët publikë gjegjësisht Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku i njëjti ka përcaktuar:

- Neni 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësiive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*
- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësiive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave*

zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

-Nenit 57 paragrafi 2 : “ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.

-Nenit 58, paragrafit 2: 2.Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar në ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë konstaton së kërkesa për inicim të procedurës disiplinore dhe po ashtu edhe Vendimi Nr. ref.01/2025, i datës 24.01.2025, i Komisionit Disiplinor, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk përmbajnë ndonjë përcaktim ligjor mbi bazën e të cilit veprimet dhe sjelljet e ankuesit lidhur me refuzimin do të cilësoheshin si veprime të kundërligjshme. Për me tepër, Komisioni Disiplinor më vendimin e atakuar jep konstatime të përgjithësuara, ashtu që, nuk ka dhënë cilësim të shkeljes disiplinore të ankuesit dhe nuk konstaton fare së veprimet e ankuesit a janë shkelje të natyrës së lehtë apo të rëndë disiplinore, dhe së masa disiplinore po ashtu është shqiptuar pa ndonjë referencë ligjore. Në vlerësimin e Kolegjit akti më të cilën vendoset për përgjegjësinë disiplinore të zyrtarit publik krijon pasoja juridike në raporte më të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës në Shërbim Civil, andaj, edhe si i tillë ky akt administrativ duhet të përmbaj të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç përcaktohet me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, ashtu që të vërtetohet drejtë në mënyrë të plotë gjendja faktike, duke argumentuar saktë me prova materiale veprimet-mos veprimet që përbejnë shkelje disiplinore, bazën ligjore dhe faktet relevante të vendosjes. E në këtë kontekst, një akt administrativ i nxjerr në kundërshtim më elementet e detyrohem është akt i

paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën-pika 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rrjedhimisht, sipas pikës II të dispozitivit të Vendimit me Nr. ref.336/2024, të datës 03.08.2024, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi fillimin e realizimit të detyrave dhe obligimeve në Ambasadën e Republikës së Kosovës me seli në Dakar/Senegal, duhej ta fillonte nga data 01.10.2024, ndërsa, sipas shkresave të lëndës ankuesi asnjëherë nuk ishte konsultuar apo njoftuar lidhur me këtë proces të emërimit, ashtu që, ankuesit ti jepej mundësia e parashtrimit të arsyeve(familjare dhe shëndetësore) mbi bazën e të cilave ka kundërshtuar shkuarjen në mision të jashtëm sipas vendimit Nr. ref.336/2024, të datës 03.08.2024, veprime këto të organit të punësimit që bien ndesh më nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të informohet për procedurat dhe vendimet lidhur me marrëdhënien e saj/tij të punës”,* dhe nenin 9 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: *“2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj”;*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, institucionet publike në kuadër të ushtrimit të autorizimeve dhe përgjegjëseve nga fusha e veprimit ligjor, duhet të përcaktojnë qartë procedura të veprimit, përfshirë edhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të zyrtarëve publikë, procedura këto që garantojnë siguri juridike, profesionalizëm, konkurrencë dhe transparencë. Andaj, mbi këtë bazë të konstatimit, dhe duke qenë së MPJD. siç u tha me sipër nuk ka akte ligjore që ka rregulluar procedurën e emërimit dhe ndërprerjes së shërbimit diplomatik-konsullor, atëherë, nisur edhe nga rasti i ankuesit, Kolegji thekson së në raste e tilla të ngjashme duhej të vinin në zbatim përshtatshmërisht procedura e thirrjes për gradim duke dhënë mundësinë për shprehje të interesi për çdo zyrtarë që pretendon së plotëson kriteret për emërim në pozitën përkatëse.

Përmbledhur si më sipër, e në mbështetje të rrethanave dhe konstatime si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin së pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar, dhe si rrjedhojë akti i kontestuar është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, kështu që, sipas nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.339/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit A.H;*
- *Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së;*